

INTERVISTA

Nga reality show pa asnjë kacidhe, te historitë e emigrantëve të suksesshëm

Në vitet '90 Davide Ded Ndoj vendosi që të emigrojë jashtë vendit. Si shumë emigrantë peripecitë që ka kaluar, fillimisht në Greqi e më pas në Itali, nuk kanë qenë të lehta. Megjithatë ëndrra për të qenë pjesë e artit rritej çdo ditë brenda tij. Pas 26 vitesh, na rrëfen se gjendet mes artistëve shqiptarë dhe jo vetëm. Teksa na tregon se si i ka lindur ideja të realizojë reality show-n "Artisti Appiedati", duke u mbështetur te historia e tij e vërtetë e emigrimit, në të cilën do të marrin pjesë 20 konkurrentë të fushave të ndryshme, si balerinë, këngëtarë, aktorë etj. shton se ata do të bëjnë një rrugëtim nga Roma në Milano për të dhënë shfaqje të ndryshme nga duhet të fitojnë ardhura, që t'i mbijetojnë udhëtimit.

Davide, si i kujton vitet e para të largimit nga Shqipëria?

Vitet e para të largimit nga Shqipëria i kujtoj me mall dhe nostalgji. Kujtoj vuajtjet dhe sakrificat e rrugëtimit për të emigruar jashtë vendit. Kanë qenë ditë të tëra që kam ecur në këmbë për të mbërritur në Greqi, përpara se të mbërrija në Itali.

Nga fillimet e tua në fushën e artit, çfarë mban mend?

Unë kisha dëshirë të bëhesha gazetar dhe të ndiqja fushën e artit, por fillimet kanë qenë shumë të vështira për mua, sepse që i vogël më është dashur të përballem me sfida të ndryshme.

Si janë krijuar këto eksperiencat tek ti, për shkak të nevojës apo dëshirës?

Mendoj që nevoja dhe dëshira janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Si çdo i ri, kisha dëshirat e mia, por njëkohësisht ishte dhe nevoja për të mbijetuar. Kisha një rreth shoqëror që punonin në fushën e artit, në lokale, si balerin të stilit latino-amerikan apo si imazhe lokale dhe firmash. Eksperiencat e mia nisnin që këtu, por dhe pjesëtarët e familjes sime merren me art (bashkëshortja pianiste dhe vajza studion për balerinë dhe kanto). Falë dëshirës për t'u marrë me art hapa agjencinë time. Nga këto eksperiencat mbaj mend se në vitin 2007 Klajdi Selimi sapo kishte dalë nga programi Amici di Maria de Filip-

pi-t dhe në trup kishte stampuar shqiponjën dykrenore. Ishte duke kërcyer, kur unë e ndjeva dyfish krenarinë shqiptare. Eksperiencë tjetër është edhe bashkëpunimi për dokumentarin e realizuar nga TVSH në komunitetin arbëresh në San Demetrio Corone në provincën e Kozencës Regio Calabria. Në dokumentar rrëfëhet historia dhe traditat e arbëreshëve. Është realizuar nga gazetarët Engjëlli Ndocaj, Arben Tafilit dhe kameramani Adriatik Berdaku.

A ka një artist që përfaqëson një model për ty?

Rikard Larja është aktori që ka luajtur "Rrugë të Bardha" (1974) një ndër filmat më të bukura e më të realizuara të asaj kohe, personazhin me emrin Ded, siç më quajnë mua. Gjithashtu dëshira ime e madhe është të kem sa më shumë artistë shqiptarë për t'i përfaqësuar në Itali dhe jashtë. Në veçanti dëshiroj të bashkëpunoj me Rita Orën.

Gjithashtu jo pak vëmendje u keni kushtuar edhe historive për emigrantët. A mund të veçosh prej këtyre historive?

Histori ka shumë. Me kolegët e mi Enzo Carrozzini dhe Klajdi Selimin kemi shkruar një program televiziv të quajtur "Ricomincio da ovest storie di immigrazione". Histori emigrantësh, që shpresoj që së shpejti do të realizohen dhe lancet në televizion. Një ndër to është historia e avokatit Gentian Alimadhit, i cili jeton dhe punon në Itali me tre studio ligjore.

Çfarë përfaqëson për ty arti, dhe cili është qëllimi i asaj që bën?

Unë përdor shpesh këtë citat të Giovanni Paolo II: Pa artin njeriu do të mbetet gjerësisht i verbër ndaj vetes së vet, botës së vet të brendshme.

Dhe së fundmi, cilat janë projektet e tua të ardhshme?

Këto ditë në Itali kam lancuar Scotch e Style dizajnime në trupin e modeleve me punime artizanale, duke përdorur materiale, si izolant elektrik, svarovski gurë brilant pse jo dhe diamant për sfilata, show e spektakle të ndryshme. Prezantimi i parë u bë në trupin e Amandha Fox për kalendarin e saj, që do të prezantojë në vitin 2017.